

NJOFTIM

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Vendimin nr. 19, datë 14.07.2017 të Bordit të Administrimit "*Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për punësimin e personelit administrativ në vendet e lira të punës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë*" shpall njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë:

PERSONEL ADMINISTRATIV

Specialist Finance në Sektorin e Financës dhe Realizimit të Buxhetit pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- a. Kontabilizon të ardhurat mujore sipas fakulteteve.
- b. Kryen kontabilizimin e bankës, të shpenzimeve, të situacioneve, të të ardhurave.
- c. Ndhmon Drejtorinë në mbylljen e pasqyrave financiare.
- d. Kryen punë administrative të natyrave të ndryshme, sipas problematikave që dalin.
- e. Ndhmon Drejtorin dhe Administratorin për hartimin e planit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor.
- f. Kontrollon të gjithë praktikatat që vijnë për likuidimin për saktësinë e dokumentacionit dhe të fondit të përdorur, duke ballafaquar me buxhetin e planifikuar.
- g. Kontabilizon magazinën dhe e rakordon atë çdo 3-muaj me magazinierin.

Kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor", Fakulteti i Ekonomisë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Kërkesë për këtë pozicion;
2. Jetëshkrim;
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave (noterizuar)
4. Kopje e librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit ID;

6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm.
8. Dëshmi të kualifikimeve;
9. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit (të noterizuar).
10. Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
11. Vërtetimi gjendjes gjyqësore
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Spektori i Burimeve Njerëzore , do të njoftoi kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi financat publike dhe legjislacionin financiar
- b. Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
- c. Njohuritë mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" ;
- d. Udhëzimi Nr. 2 datë 06.02.2012"Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- e. Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- f. Njohuritë mbi Ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;
- g. Njohuritë mbi Kodin e Procedurave Administrative;
- h. Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë".

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:

- **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë,
Lagja. “Pavarësia”, Rr. “Kosova” 9400
Vlorë, Shqipëri.**
- **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve
Njerëzore**
- **Për pozicionin: “Specialist Finance” pranë
Sektorit të Realizimit të Buxhetit në Drejtorinë
e Shërbimeve Mbështetëse**

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 05.05.2021 dhe afati përfundon në datën 20.05.2021.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 20.05.2021, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

**DREJTOR
ELOINA TOZAJ**